



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Komunitete
Z./Znj. _____

Në bazë të nenit 53 të Ligjit për Qeverisje Lokale dhe nenit 42 të Statutit të Komunës së Novobërdës:

F T O J

Mbledhjen e tretë të Komitetit për Komunitete e cila do të mbahet më **11.06.2018** (e hënë) duke filluar në orën **10:00**.

R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raporti i punës së Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete;
3. Të ndryshme

Mbledhja do të mbahet ne lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Me: 04.06.2018
Në: Novobërdë



Shpresa Kqiku
Kryesuese e Komitetit për Komunitete



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 23.05.2018, duke filluar në orën 10:00. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Komitetit për komunitete Shpresa Kqiku, Anëtarët e Komitetit: Abdyl Gashi, Dobrivoje Djordjovic, Jorgovanka Filic, Behare Jashari, Aleksander Pavic, Xhevat Mehmeti, Nënkrjetari i Komunës Sinisa Dmic, Zv.Kryesuesi i kuvendit për komunitete Bajrush Ymeri, Zyrtari për Sherbime Publike Bajram Abazi dhe përfaqësuesit e OSBE-së dhe UNMIK-ut.

Kryesuesja e Komitetit pasi përshendeti të pranishmit tha: e hapi mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit;
2. Raporti i punës së Zyrës Komunle për Kthim dhe Komunitete;
3. Ndriqimi publik në fshatin Pasjak;
4. Problemet me ujëra të zeza në teritorin e Komunës së Novobërdës (fsh.Kufc, Pasjak dhe Vllasali);
5. Të ndryshme;

Shpresa Kqiku i pyeti të pranishmit a pajtohen me rend dite?

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: kishte qenë mirë të ndrohet orari i mbledhjes nese pajtoheni edhe ju, pra të mbahet para mbledhjes se KPF-së dhe Kuvendit në mënyrë që të kemi mundësi të shtojm pika për Kuvend.

Aleksander Pavic pasi përshendeti të pranishmit tha: mendoj se duhet të kemi një rregullore të punës ne si komitet për komunitete, e dyta është se në ftesat të cilat i keni dërguar nuk është cekur vendi se a mbahet ne ndërtesë të Kuvendit Komunal apo në cilen sall dhe kur diskutojm për rend ditë duhet të deklarohejm a jemi për apo kundër pasi që në mbledhjen e kaluar nuk jemi deklaruar. Xhevat Mehmeti pasi përshendeti të pranishmit tha: është e vërtet që ka gabime teknike por kryesuesja është e re dhe është vetem fillim, të gjitha kërkesat tuaja janë të drejta dhe kisha kërkuar edhe nga OSBE-ja që ta ndihmoni kryesuesen dhe besoj që me kohë do të rregullohen këto vërejtje tuaja.

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua njëzëri nga anëtarët e Komitetit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit.

Pasi nuk pati diskutime procesverbali u aprovua njëzëri nga anëtarët prezent të Komitetit.

Pika e dytë: Raporti i punës së Zyrës Komunle për Kthim dhe Komunitet;

Shpresa Kqiku tha: pasi që mungojn zyratret komunal për kthim dhe komunitete vazhdojm me piken e tretë.

Pika e tretë: Ndriqimi publik në fshatin Pasjak;

Për këtë pikë Kryesuesja e Komitetit ja dha fjalën zyrtarit të sherbimeve publike Bajram Abazi . Bajram Abazi pasi përshendeti të pranishmit tha: sa i përket ndriqimit në fshatin Pasjak është e planifikuar në startegjin që kemi punuar me organizaten Demos 2018/19, si projekt prej Komune nuk kemi mundur ta planifikojm për këtë vit, jemi duke i shikuar mundësit me donator në riparimin dhe ndërtimin e ndriqimi publik.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Jorgovanka Filic pasi përshendeti të pranishmit tha: po kyqem në këtë pikë rreth ndriqimit publik po flas për fshatin Jasenovik aty të udhëkryqi i rrugës është edhe objekti i shkollës fillore disa herë janë vërejtur automjete të dyshimta por fatkeqësisht për shkak të mungesës së ndriqimit publik nuk kemi mundur të vërejm se kush për çka është aty edhe pse objekti i shkollës ka roje por kishte qenë mirë që edhe ajo pjesë të kyçet në projekt të ndriqimt publik.

Bajram Abazi tha: ne e kemi strategjin që e kemi punuar vitin e kaluar është e planifikuar edhe fshati Jasenovik por nuk e kam startegjin para vetes që ta shikoj se për cilin vit është planifikuar.

Xhevat Mehmeti tha: lidhur me ndriqimin në fshatin Pasjak i kam disa pyetje pasi që kërkesë e imja qysh moti ka qenë ndriqimi në fshatin Pasjak pasi që edhe Kryetari i Komunës na ka premtuar në mandatin e kaluar dhe në të gjitha fshtrat tjerë ka ndërtuar ndriqim publik, dhe sa për informacion Pasjaki është një nga tatimpaguesit më të mëdhaj në Komunë andaj kërkoj që të kaloj si projekt në Kuvend me aq mundësi që ka. E kam edhe një kërkes tjetër për ujëra të zeza pasi që kemi shumë problem, zyrtari i sherbimeve publike e din pasi që kemi bërë kërkesë që 1 vit pasi që tre kanalizime jan bllokuar prandaj kërkoj sanimin e të gjitha kanalizimeve.

Bajram Abazi tha: për ndriqim në fshatin Pasjak kemi diskutuar shumë herë edhe me Kryetarin e Komunës, mirëpo nuk kemi pasur mjete të mjaftueshme për ndërtim të ndriqimit publik, ndërsa sa i përket kanalizimeve sa hërë që kemi marr kërkesë Hidromorava ka dal në terren dhe ka bërë hapjen gjithashtu jemi duke punuar në një projekt që të rregullohe në gjith teritorin e Komunës.

Abdyl Gashi tha: mendoj që qytetarët po zhgenjehen duke pritur për projekte, por projektet pa mirëmbajtje janë dështim dhe kjo po ndodh pas një muaji që po ndërtohet ndriqimi në një lagje nuk është funksional, mendoj që Komuna duhet të gjejnë një model të ndonjë Komune tjetër për afërsisht të ngjajshme në mënyr që të gjej një mënyr për mirëmbajtje, po zhgenjehet si qytetari ashtu edhe donatori i cili po financon dhe është e pamundshme që të fitojm projekte të reja, po lidhem përseri të orari nuk e kam për kritik por mendoj se na shërben në mënyr që të kemi mundësi të shtojm pika për mbledhje të Kuvendit, ne e patem një pikë dhe përfaqësuesi i zyres komunale për kthim nuk ishte prezent prandaj kisha kërku që për këto mbledhje të jemi më serioz.

Pika e katërt: Problemet me ujëra të zeza në teritorin e Komunës së Novobërdës (fsh.Kufc, Pasjak dhe Villasali);

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Behare Jashari pasi përshendeti të pranishmit tha: në rrugën kryesore në fshatin Bostan afër shkollës Miladin Popovic është dëmtuar rrjeti i kanalizimit, ujërat e zeza kalojn në mes të rrugës dhe kundërmon një erë të keqe, unë si përfaqsuere e komunitetit rom kërkoj nga Komuna që të intervenoj dhe rregulloj kanalizimin.

Bajram Abazi tha: të gjitha prishjet që janë do ti riparojm me këtë projekt që kemi për riparim të kanalizimev.

Pika e pestë: Të ndryshme.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Zv.kryesuesi i kuvendit për komunitete Bajrush Ymeri pasi përshendeti të pranishmit tha: fillimisht e ndaj mendimin me diskutuesit me herët që mbledhja e komitetit për komunitete të thirret para KPF-së dhe seances së Kuvendit në mënyrë që pikat të cilat diskutohen këtu të ken mundësin të shkojnë në KPF dhe Kuvend, duke e pasur paraysh afatin ligjor për këto mbledhje duhet ditur që mbledhja të thirret në javën e parë të muajit çdo herë. Të ju informoj se ne së bashku me Kryesuesen dhe antaren e komitetit për komunitete Jorgovanka Filiq kemi marrë pjesë në një takim në Prevall të organizuar nga OSBE-ja me 17 dhe 18 maj ky takim ka pasur për qëllim që ti ofroj në një tryez të gjithë këta mekanizma që e përbejnë komitetin në regjion të Gjilanit, kemi pasur rast ta takohemi me zv. Kryesues, me kryesues të komitetit për komunitete, nënkryetarë për komunitete, shefa të zyrës së komuniteteve dhe antarë të komitetit për komunitete dhe bashkarisht kemi diskutuar për rolin e komiteteve, detyrat dhe përgjegjësit poashtu kemi diskutuar për planin e punës që duhet për mbledhje të komitetit për komunitete gjatë një viti kalendarik, pasi që Shpresa si Kryesuese e komitetit nuk pat mundësi me qëndru ditën e dytë plani i punës është diskutuar në ditën e dytë dhe unë e pata rasti që së bashku me anteren e komitetit për komunitete ta hartojm në pika të shkurta një plan, por unë ju kisha sugjeru që një ditë në një takim të përbashkët të uleni dhe të diskutoni për planin e punës. Dobrivoje Djordjevic tha: edhe në mbledhje të Kuvendit e kam parashtruar këtë pyetje por ende nuk kam marrë ndonjë përgjigje, në fshatin Stanishor është shëndrruar deponi për mbeturina kam kërkuar që inspektori sanitar të del në terren dhe të bëjë një plan të punës që të ndërpritet puna, pra është bërë një deponi publike ku gjithë qytetarët e Gjilanit i hedhin mbeturinat e objekteve që i shkatrojnë, më heret kur kam parashtruar kërkes në inspektor më kanë thënë që skan mjete për me pagu një inspektor dhe kjo një përgjigje shumë joreale, andaj kishte qenë mirë që të diskutohet dhe të zgjidhet ky problem një herë e përgjithmon.

Xhevat Mehmeti tha: pajtohem me parafolsin edhe pse secili antarë po i ngrit shqhtësimet e fshatit të vet por ashtu jemi të zgjedhur dhe më të vërtet deponia është shumë e keqe në at fshat. Vjosa Emini përfaqësuese nga OSBE-ja tha: për me i ndëgjju problemet edhe të fshatrave tjer që nuk kan përfaqësues kishte qenë mirë të organizohen takime nga ju në fshatrat që mendoni se ka më shumë probleme, me i ndëgjju brengat e tyre dhe mandej ti diskutoni këtu.

Abdyl Gashi tha: pajtohem me kolegen por në të gjitha fshatrat ka probleme me kanalizim, ndriqim, trotuar, por ajo qe më pengon mua është se nuk sistemohen punët prej qeverisjes pasi që ka fshatra të cilët nuk kan as rrug, as ndriqim as kanalizim e në anen tjetër ka fshat që janë të gjitha kushtet ose mungon vetem ndriqimi dhe aty fokusohen pra mos ta shfrytëzojm ndikimin e përfaqësimit aty ku jemi por të shikojm edhe fshatrat tjerë që nuk kan përfaqësim.

Sasa Ristic përfaqësues i UNMIK-ut tha: i dëgjova propozimet tuaj që i keni për një funksionim më të mirë, ndoshta kishte qenë mirë që në planin e punës ti parshihni edhe vizitat në terren për katër vite, fillimisht të fokusoheni në rregullimin e infrastrukturës bazë dhe e dyta të fokusoheni në identifikimin e vendeve turistike pasi që është një Komunë e pastërt dhe do të kemi mundësi për një zhvillim më të mirë ekonomik.

Abdyl Gashi tha: kërkoj nga D.SH.P të na siguroj të gjitha projektet të cilat jan realizuar, cilat fshatra janë përfshir në projekte dhe cilat nuk preken fare në projekte, në mënyrë që edhe ne ti kemi si prioritet që ta shtyjme si projekt në punë.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falëndëroi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00

Valmire Mustafa

Procesmbajtëse



Shpresa Kqiku

Kryesuese i Komitetit për Komunitete

